

**Raporti i përgjithshëm i vlerësimit të infrastrukturës nga studentët  
për vitin akademik 2022/2023  
Zyra për Sigurim të Cilësisë**

## **1. Hyrja**

Duke u bazuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë Akademisë Tempulli është bërë Vlerësimi i Infrastrukturs dhe Shërbimeve nga studentët për Semestrin dimëror 2022/2023 në mënyrë që të mbliidhen këndvështrimet e tyre për të gjitha aspektet.

Në këtë raport, është paraqitur dhe përshkruar vlerësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve nga të gjithë studentët e programeve të BA Sigurimet dhe Menaxhimi i Dëmeve nga Aksidentet, BSc. Inxhinieria e Trafikut dhe Transportit, MSc Inxhinieria e Trafikut dhe Siguria Rrugore. Meqë është hera e parë që Akademia Tempulli e realizon këtë pyetësor duke qenë që është vitin i parë akademik, raporti nga të dhënat e paraqitura për vlerësim të infrastrukturës për vitin akademik 2022/2023.

Vlerësimi infrastrukturës dhe shërbimeve këtë vit është realizuar përmes pyetësorëve të vendosur në SEMS si pjesë e vlerësimit të programit. Ndryshimi i formës së grumbullimit të dhënave nga ajo manuale në formën të dixhitalizuar, siguron një pjesëmarrje të plotë të respondentëve në procesin e vlerësimit. Komisioni për sigurim të cilësisë ka aprovuar pyetësorin e vlerësimit të infrastrukturës. Infrastruktura dhe shërbimeve vlerësohen nga të gjithë studentët e BA Sigurimet dhe Menaxhimi i Dëmeve nga Aksidentet, BSc. Inxhinieria e Trafikut dhe Transportit, MSc Inxhinieria e Trafikut dhe Siguria Rrugore dhe realizohet një herë brenda një viti akademik. Pyetjet për këtë sesion kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- pajtohem pjesërisht; 4-pajtohem; dhe 5- pajtohem plotësisht).

### **1.1 Raporti përgjithshëm i vlerësimit të cilësisë së Infrastrukturës dhe Shërbimeve për vitin akademik 2022/2023**

Në rezultatet e vlerësimit të Infrastrukturës dhe Shërbimeve të paraqitura në tabelën nr.1 shohim se nga 17 komponentet të paraqitura në këtë sesion vlerësimi mesatarë është mbi 3

(3- pajtohem pjesërisht) e tutje. Nga rezultatet e vlerësimit të Infrastrukturës dhe shërbimeve komponentë më i vlerësuar nga studentët është pjesa e informacionit përfshirë tabelat e shpalljes, web faqen, dhe rrjetet sociale, gjithashtu, mirëmbajtja e hapësirave dhe gatishmëria e menaxhmentit përfshirë edhe Koordinatorin për trajtimin e kërkesave të studentëve qoftë edhe përmes takimeve është vlerësuar më së shumti këtë vit akademik. Të gjitha komponentet e tjera, janë vlerësuar mbi 3 (pajtohem pjesërisht), rezultat ky që kërkon adresim të komponenteve të caktuara që i kontribuojnë përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Elementet më së paku të vlerësuar sa i përket vlerësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve që Akademia Tempulli duhet ti adresoj janë: qasja e studentëve në fotokopje, në literatura dhe në bibliotekë.

Në përgjithësi rezultatet e vlerësimit janë pozitive, por Akademia Tempulli duhet të fokusohet që të ngritë cilësinë në të gjitha komponentët të ku ka mundësi dhe hapësirë.




Tabela nr.1 Vlerësimi I Infrastrukturës dhe Shërbimeve të studentëve për vitin akademik  
2022/2023


Nr.	Pyetjet vlerësuese	Mesatarja
1	Menaxhmenti është i hapur për vërejtjet, sugjerimet dhe kërkesat e studentëve	4.16
2	Bartësi i programit është në kontakt të vazhdueshëm me studentë	4.36
3	Zyra për sigurimin e cilësisë ofron informacione të bollshme për studentë	4.22

4	Zyra për marrëdhënie me jashtë ofron informacione të bollshme për studentë	4.09
5	Zyra për Shërbimin e Studentëve ofron shërbime të kënaqshme	3.72
6	Sallat e mësimi dhe laboratorët ofrojnë kushte të nevojshme për mësim cilësor.	3.82
7	Mirëmbajtja e hapësirave (niveli i pastërtisë) është në nivelin e duhur	4.03
8	Sallat e kompjuterëve janë në dispozicion të studentëve	4.07
9	Institucioni ka bibliotekën me literaturë profesionale të bollshme	4.06
10	Biblioteka ofron shërbime cilësore për studentë	3.98
11	Institucioni posedon salla të veçanta të leximit për studentë	4.04
12	Studentët kanë qasje në shtypjen dhe fotokopjimin e materialeve për lexim në program	4.06
13	Tabelat e shpalljeve për studentë përmbajnë informacione të bollshme dhe të vazhdueshme	3.96
14	Studentët kanë qendra për rekreacion brenda hapësirës	4.36
15	Personeli i njësisë për TI ofron shërbime të nevojshme	3.93
16	A keni vërejtur ndryshime në vendim marrje	4.34
17	Si e vlerësoni mbarëvajtjen e procesit mësimor gjatë situatës COVID-19	4.04

## 1.2 Raporti i detajuar i vlerësimit të cilësisë së Infrastrukturës dhe Shërbimeve për vitin akademik 2022/2023 në nivel programi dhe specializimi

Grafiku i mëposhtëm tregon mesataren e vlerësimit për të gjitha programet dhe specializimet në Akademinë Tempulli për vitin akademik 2022/2023, ku nota mesatare e vlerësimit në nivel institucioni është 3.79, me pjesëmarrje të 107 respondentëve, respektivisht studentëve.

Grafiku nr.1 Vlerësimi Infrastrukturës dhe Shërbimeve të studentëve për vitin akademik 2022/2023 për të gjitha programet dhe specializime gjeneruar nga SEMS



### BA Sigurimet dhe Menaxhimi i Dëmeve nga Aksidentet

Në programin BA Sigurimet dhe Menaxhimi i Dëmeve nga Aksidentet vlerësimi mesatar është 4, ku pjesëmarrës në vlerësim ishin gjithsej 5 studentë. Ndërkohë ky program ka numër të vogël të studenteve, ku në vitin akademik 2021/2022 janë regjistruar gjithsej 10 studentë, ndërsa në vitin akademik 2022/2023 nuk është regjistruar asnjë studentë.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura rezultatet e detajuara për programin BA Sigurimet dhe Menaxhimi i Dëmeve nga Aksidentet në gjithsej 17 komponente, dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- pajtohem pjesërisht; 4-pajtohem; dhe 5- pajtohem plotësisht).

### BSc Inxhinieria e Transportit dhe Infrastruktura

Në programin BSc Inxhinieria e Transportit dhe Infrastruktura me Specializimet Inxhinieria e Trafikut dhe Transportit dhe Inxhinieria e Infrastrukturës (rrugë, hekurudhë, hidrologji) mesatarja e vlerësimit është 4.09 me numër gjithsej të respondentëve 61.

## MSc Inxhinieria e Trafikut dhe Siguria Rrugore

Në programin MSc Inxhinieria e Trafikut dhe Siguria Rrugore me Specializimet Inxhinieria e Trafikut dhe Transportit dhe Siguria në Rrugë dhe Menaxhimi i Aksidenteve mesatarja e vlerësimit është 4.03 me numër gjithsej të respodentëve 41.

Tabela nr.2 Vlerësimi I Infrastrukturës dhe Shërbimeve të studentëve për vitin akademik 2022/2023 në Programin BA , BSc dhe MSc

Nr.	Pyetjet vlerësuese	BA	BSc	MSc
1	Menaxhmenti është i hapur për vërejtjet, sugjerimet dhe kërkesat e studentëve	3.8	4.03	4.64
2	Bartësi i programit është në kontakt të vazhdueshëm me studentë	4.83	4.05	4.21
3	Zyra për sigurimin e cilësisë ofron informacione të bollshme për studentë	4.17	4.19	4.29
4	Zyra për marrëdhënie me jashtë ofron informacione të bollshme për studentë	4	4.19	4.07
5	Zyra për Shërbimin e Studentëve ofron shërbime të të kënaqshme	3.83	3.96	3.36
6	Sallat e mësimit dhe laboratorët ofrojnë kushte të nevojshme për mësim cilësor.	3.5	4.03	3.93
7	Mirëmbajtja e hapësirave (niveli i pastërtisë) është në nivelin e duhur	3.5	4.29	4.29
8	Sallat e kompjuterëve janë në dispozicion të studentëve	4.5	4	3.71
9	Institucioni ka bibliotekën me literaturë profesionale të bollshme	4.14	4.19	3.86
10	Biblioteka ofron shërbime cilësore për studentë	4.33	3.96	3.64
11	Institucioni posedon salla të veçanta të leximit për studentë	4	3.84	4.29
12	Studentët kanë qasje në shtypjen dhe fotokopjimin e materialeve për lexim në program	4.5	4.03	3.64
13	Tabelat e shpalljeve për studentë përmbajnë informacione të bollshme dhe të vazhdueshme	4	3.88	4

<b>14</b>	Studentët kanë qendra për rekreacion brenda hapësirës	4.17	4.92	4
<b>15</b>	Personeli i njësisë për TI ofron shërbime të nevojshme	3.33	4.11	4.36
<b>16</b>	A keni vërejtur ndryshime ne vendim marrje	5	4.08	3.93
<b>17</b>	Si e vlerësoni mbarëvajtjen e procesit mësimor gjatë situatës COVIT-19	4	3.84	4.29

